

DOKUMENTA DHE MATERIALE

JORGO BULO

RRETH NJË DORËSHKRIMI TË ÇAJUPIT

Midis veprave në dorëshkrim të A.Z. Çajupit, që ruhen në fondin me emrin e tij në Arkivin Qendror Shtetëror të RPSH, kohë më parë kemi gjetur një shkrim me interes nga sfera e krijimit publicistik të shkrimtarit, të cilin nuk kemi pasur rast gjer më sot t'ja bënim të njohur opinionit shkencor.

Dorëshkrimi në fjalë mban titullin «Dhe neve të krishterë jemi» dhe është, me sa duket, forma përfundimtare e një artikulli që Çajupi e pat shkruar për ta botuar në ndonjë gazetë të kohës.

Por nuk dimë të jetë botuar, as me gjallje të poetit, e aq më pak më vonë. Gjer pesë vjet më parë asnjë burim për Çajupin nuk ka bërë fjalë për këtë artikull¹. Edhe sot artikulli nuk njihet integralisht² dhe nuk është bërë objekt trajtimi të veçantë, prandaj na duket jo pa interes botimi i tij i plotë si dhe shfaqja e disa mendimeve rreth kushteve në të cilat u shkrua dhe vlerës që paraqet, si një fakt i ri që hedh dritë për qëndrimin e Çajupit ndaj çështjes kombëtare në fillim të viteve 20 të këtij shekulli, periudhë gjatë së cilës veprimtaria e poetit është pak e njohur prej nesh. Ky shkrim ndihmon gjithashtu për të plotësuar në një tjetër aspekt përfytyrimin tonë mbi karakterin konsekuent të pikëpamjeve demokratike të Çajupit.

Artikulli «Dhe neve të krishterë jemi», siç e sqaron brendia e tij, është shkruar si përgjigje kundër një memorandumit që një grup i borgjezisë ortodokse të Korçës, i kryesuar nga Koço Kota, i drejtoi më 13 shkurt 1921 qeverisë së atëhershme.

Për të gjykuar mbi vlerën e artikullit dhe pozitën që zë Çajupi ndaj çështjes së «autonomisë» së disa viseve të Shqipërisë jugore, është e nevojshme të japim në vija të përgjithshme disa shpjegime rreth çastit historik që po kalonte vendi ynë si dhe rreth historisë së memorandumit në fjalë.

Fill pas Kongresit të Lushnjës, në vitin 1921, kur shteti i ri shqiptar sapo kish mbushur motin e parë të pavarësisë së vet faktike, u dukën shenjat e thellimit të kontradiktave klasore dhe të acarimit të luftës për zgjidhjen e një vargu problemesh politike, ekonomike e shoqërore,

1) Për herë të parë titullin e këtij artikulli e kemi zënë në gojë në shënimet tona *Çajupi në kujtimet e bashkëkohësve*, botuar në rev. «Ylli», 1966, 3, f. 10.

2) Gj. Zheji në studimin e vet *Andon Zako Çajupi, Jeta dhe vepra*, T. 1966, f. 33-34, citon një fragment nga ky artikull dhe boton faksimilen e faqes së tij të parë.

që kishin të bënin sidomos me stabilitetin dhe demokratizimin e jetës së brendshme të vendit.

Në pasojë të kësaj lufte, që kishte nisur prej kohe në gjirin e forcave politike të vendit, uniteti kombëtar i vendosur në Kongresin e Lushnjës ishte lëkundur disa muaj pas kësaj ngjarjeje dhe, si rrjedhim, qeveria e Sulejman Delvinës kishte dhënë dorëheqjen e ishte zëvendësuar në nëntor të 1920-ës nga qeveria e Iljaz Vrionit. Zhvillimet e mëvonshme nxorën në rend të ditës nevojën për zgjedhjet parlamentare.

Mirëpo fushata elektorale u zhvillua në rrethana të brendshme dhe të jashtme mjaft të vështira për vendin.

Shqipëria që kishte dalë nga robëria mesjetare turke dhe kishte kaluar përmes luftrave ballkanike, luftës së parë botërore dhe trazirave politike të shkaktuara nga lëvizjet e brendshme antikombëtare, ishte rrënuar ekonomikisht dhe përballonte vështirësi të mëdha financiare. Nga ana tjetër, kufijtë ishin të pasiguruar dhe nën kërcënimin e vazhdueshëm të shteteve shoviniste fqinje, sidomos të borgjezisë reaksionare greke, e cila nuk kishte hequr dorë nga pretendimet territoriale ndaj viseve jugore të atdheut.

Duke përfituar nga mungesa e unitetit të forcave politike dhe e stabilitetit të brendshëm të shtetit shqiptar, për të krijuar një situatë të favorshme që do t'u jepte rast të vinin në jetë planet e tyre, qarqet reaksionare të borgjezisë shoviniste greke bënë çmos të pengonin me të gjitha mjetet zhvillimin normal të zgjedhjeve. Për të mënjeluar nga pjesëmarrja në zgjedhjet parlamentare popullatën ortodokse të Shqipërisë së jugut, këto qarqe, vunë në lëvizje sidomos klerikët e lartë ortodoksë, agjentë të yre, përdorën ndasinë fetare si mjet mashtrimi dhe nxitën ose shfrytëzuan tendencat separatiste, ambicjet politike dhe prirjet kantonale të disa krerëve borgjezë e feudalë, në të cilat shprehej lufta e tyre për të zënë pozita në shtetin e ri shqiptar.

Ndërsa në Gjirokastër pengesat që krijuan shovinistët grekë, të për-krahur nga mitropoliti i atjeshëm, u kapërcyen më lehtë dhe populli mori pjesë në zgjedhje, në Korçë situata u komplikua për shkak të veprimeve të grupit të K. Kotës. Duke shfrytëzuar pakënaqësinë e një pjese të borgjezisë ortodokse korçare, e cila ishte e pakënaqur nga që pushteti që përqendruar në duart e bejlerëve muhamedanë, ky grup, i nxitur nga ambicja dhe interesat e tij të ngushta, kur pa se fushata e zgjedhjeve nuk po zhvillohej në favorin e vet, nisi të spekulojë me ndjenjat fetare të popullatës dhe orientoi të krishterët t'i bojkotonin zgjedhjet. Qarqet shoviniste greke, që mezi e prisnin këtë rast, e shfrytëzuan menjëherë për qëllimet e tyre dhe me anë të shtypit e veglave që kishin në Shqipëri shpërthyen një propagandë të ethshme, për të penguar pjesëmarrjen e ortodoksve shqiptarë në zgjedhje.³

Por pjesa dërmuese e popullatës ortodokse të Korçës, e sidomos të krahinave të saj, nuk ra viktimë e propagandës së qarqeve shoviniste të borgjezisë greke dhe dritëshkurtësisë së grupit të K. Kotës; ajo mori pjesë në zgjedhjet, duke provuar kështu se idealet e ruajtjes së unitetit kombëtar qenë të shtrenjta për masat, të cilat i kapërcyen në fakt paragjykimet fetare e tendencat kantonale që ushqente grupi i K. Kotës.

Rezultatet e zgjedhjeve të para, të cilat i treguan grupit të K. Kotës

3) B. Çiraku, *Zgjedhjet e para parlamentare në Shqipëri në vitin 1921* në librin *Mbi lëvizjen kombëtare dhe demokratike shqiptare në vitet 1918-1924* (botim i USHT, Instituti i historisë dhe i gjuhësisë) T. 1966, f. 160-161.

se ishin të kota shpresat e tij për të fituar vendet e deputetëve të Korçës në parlament, e shtynë këtë grup të rrëshqiste në një gabim edhe më të rëndë dhe të ndërmerre një veprim edhe më të rrezikshëm për interesat jetike të shtetit shqiptar të sapoformuar dhe për fatet e vendit: me anën e një memorandumit që grupi në fjalë ia dërgoi qeverisë më 13 shkurt 1921 kërkohej që në jugë të Shqipërisë të krijohet një administratë e veçantë, me parlament e legjislacion të vetin, me qendër në Korçë.⁴ Me këtë hap merrej një përgjegjësi e rëndë historike, sepse kërkohej në thelb autonomia e krahinave të jugut të Shqipërisë. Objektivisht kërkesa për autonomi ishte një akt antikombëtar, ajo dashur pa dashur shpinte ujë në mulli të politikës ekspansioniste të qarqeve shoveniste greke dhe inkurajonte synimet e këtyre qarqeve ndaj viseve jugore të Shqipërisë.

Këto qarqe nuk vonuan ta përdornin këtë si një provë për të mashtruar opinionin publik botëror se gjoja popullit shqiptar i mungonte vetëdija e unitetit kombëtar dhe ishte i pazoti të vetëqeverisej, se gjoja tërë të krishterët e Shqipërisë së jugut ishin për shkëputjen nga shteti shqiptar. Memorandumi u dha shkas shovinistëve grekë ta shtonin aktivitetin armiqësor kundër vendit tonë, duke kërcënuar të krishterët me anë të agjentëve të tyre dhe bandave të armatosura që të bojkotonin zgjedhjet.

Memorandumi dhe veprimet e qarqeve shoveniste të borgjezisë greke shkaktuan një valë të fuqishme proteste në Korçë, në gjithë Shqipërinë dhe kudo që banonin shqiptarë. Kjo u pasqyrua gjerësisht në shtypin e kohës, që botohej në Shqipëri dhe jashtë saj.⁵

Shtypi i bëri jehonë faktit se akti i grupit të Koço Kotës nuk shprehte aspak aspiratën e masave popullore të besimit ortodoks të cilat, me veprimin e tyre të vendosur, pa marrë parasysh dallimet fetare, në unitet me gjithë forcat e gjalla të vendit, e bënë hi memorandumit dhe nuk lejuan të realizoheshin planet e qarqeve shoviniste greke, për t'i shkëputur Shqipërisë krahinat e veta jugore.

Siç e dëshmon protesta që i dërgoi gazetës «Koha» të Korçës⁶ Filip Shiroka, i cili ka nënshkruar si Kryetar i vëllazërisë së shqiptarëve të Misirit, zhvillimi i ngjarjeve në Korçë u ndoq me shqetësim nga patriotët e asaj kolonie të cilët, të indinjuar, protestuan rreptësisht kundër memorandumit dhe autorëve të tij.

Në këtë atmosferë u shkrua edhe artikulli: «Dhe neve të krishterë jemi». Çajupi në këtë artikull ka dhënë një vlerësim objektiv të situatës historike dhe ka paraparë me qartësi dëmet e rreziqet që i vinin Shqipërisë nga ky veprim antikombëtar, i cili vërtet ishte nxitur prej ambicjes dhe verbërisë politike të grupit të K. Kotës, por shprehte në fakt dobësinë e asaj pjese të borgjezisë shqiptare, që nuk kishte besim në forcat e brendshme për vendosjen e stabilitetit politik dhe zhvillimin ekonomiko-shoqëror të vendit.

Vlerësimi që jep Çajupi për gjendjen e brendshme dhe të jashtme të vendit, dëshmon për faktin se ai ka qenë mjaft mirë i informuar për zhvillimet në Shqipëri, të cilat me sa duket i ka ndjekur hap pas hapi.

4) *Historia e Shqipërisë*, V. II (botim i USHT, Instituti i historisë dhe i gjuhësisë), T. 1965, f. 501.

5) Gazeta «Koha» 26.2.1921, 12.3.1921; Gazeta «Fjal' e lirë», 5.3.1921; gazeta «Drita», 10.3.1921, etj.

6) Gazeta «Koha» 4.6.1921.

Parashikimet e tij për konjunkturën që mund të krijoheshin pas aktit të obstrukcionistëve, për rreziqet që i vinin Shqipërisë nga jashtë dhe për ringjalljen e planeve të qarqeve shoveniste greke u përputhën plotësisht me zhvillimin e mëvonshëm të ngjarjeve.

Pozicioni që mori Çajupi ndaj ngjarjeve në Korçë u përgjigjej plotësisht interesave jetike të ruajtjes së unitetit kombëtar dhe tërësisë tokësore të shtetit shqiptar dhe u pajtua katërcipërisht me qëndrimin që mbajtën tërë patriotët e ndershëm e shtypi patriotik brenda e jashtë Shqipërisë.

Por artikulli «Dhe neve të krishterë jemi» hedh dritë edhe në një drejtim tjetër; ai dëshmon për karakterin konsekuent të pikëpamjeve demokratike të poetit i cili, duke u qëndruar besnik idealeve të rrymës demokratike në lëvizjen kombëtare, që në fillim të viteve 20, kur momenti kombëtar ende i zhvendoste në plan të dytë problemet e formës së regjimit politik dhe të shndërrimeve me karakter demokratik në jetën social-politike të vendit, shprehu përmes këtij artikulli deziluzionin që kishin pësuar shtresat e vegjëlisë të qytetit dhe të fshatit shqiptar nga që aspiratat e demokracisë dhe të përparimit shoqëror për të cilat luftuan këto shtresa po merreshin asi kohe nëpër këmbë për t'u tradhëtuar përfundimisht me vendosjen e monarkisë çifligaro-borgjeze. Me ndjenjën e një demokraci radikal në bindjet e veta Çajupi nga larg vuri re se shumë nga qeveritarët dhe nëpunësit e atëhershëm «do bejler e pashallarë» me mentalitet anadollak, harronin që kohët e para kishin kaluar dhe shfrytëzonin pozitën që kishin zënë, për t'u shërbyer interesave të klasës së tyre me mënyrat më të poshtra. Dënimi që u jep Çajupi këtyre qeveritarëve, të cilët, sipas tij, meritojnë të varen e jo të nderohen, buron prej idealeve të tij për një qeveri pa bejlerë e pashallarë, që të realizonte aspiratat e shtresave demokratike të shoqërisë shqiptare.

Është edhe më i rëndësishëm fakti që poeti nuk i sheh të mishëruara këto ideale të përparuara as në të ashtuquajturën «demokraci borgjeze të perëndimit». Duke folur për shtete të moçëm e të përparuar «që trashëgojnë një jetë kombëtare prej qindra vjet», ai, pa dyshim, ka parasysh shtetet e Evropës perëndimore, forma e regjimit politik të të cilave përbënte dikur idealin e rilindasve. Çajupi nuk ushqen iluzione as për ato, por zbulon natyrën e vërtetë të qeveritarëve të këtyre vendeve, të cilët i karakterizon si njerëz që «rjepin, vjedhin, grabitin dhe mundojnë popullin».

Pyetjes se përse mbeti i pabotuar artikulli «Dhe neve të krishterë jemi!» është vështirë t'i jepet një përgjigje e saktë. Siç del nga përmbajtja e artikullit, ai u shkrua në valën e zemërimit të përgjithshëm që shkaktoi memorandumit të 13 shkurtit të vitit 1921, me qëllim që t'u tregonte obstrukcionistëve në ç'qorrsokak kishin hyrë e t'i detyronte të kthenin udhë. Mund të mendohej se Çajupi nuk arriti ta dërgonte për ta botuar në ndonjë nga organet e kohës, meqenëse ngjarjet u zhvilluan shpejt dhe qëndrimi i vendosur patriotik i masave popullore, qofshin ato të besimit ortodoks apo mysliman, që morën pjesë bashkërisht në zgjedhje, e fshiu memorandumit. Siç dihet, zgjedhjet në tërë Shqipërinë, veç Shkodrës, morën fund më 5 prill 1921 dhe do të ishte e udhës të mendohej që pas kësaj Çajupi s'kish arësye të botonte artikullin dhe të ringjallte një çështje të vdekur. Mirëpo faktet dëshmojnë se pasojat e memorandumit nuk u kapërcyen aq shpejt, sa mund të kuptohet vetëm nga zhvillimi i zgjedhjeve, as në jetën e brendshme politike të vendit e aq më tepër në arenën e jashtme.

Shqetësimi i rretheve të patriotëve brenda vendit se mos qeveria pranonte memorandumin vazhdoi gjer vonë⁷ edhe për faktin se nuk u morën masa energjike dhe të prera kundër memorandumistëve, kurse qarqet e borgjezisë shoviniste greke vijuan ta përdornin memorandumin në Lidhjen e Kombeve, ku bisedoheshin kufij të Shqipërisë, si një provë «se populli i këtyre viseve dëshiron bashkimin me Greqinë»⁸. Duke parë këtë, autorët e memorandumit u detyruan t'i drejtonin një telegram Lidhjes së Kombeve ku thuhej se memorandumit ishte një çështje krejt e brendshme, «një farë projekti që iu parashtrua qeverisë për përmirësimin e Administratës së Shqipërisë jugore»⁹.

Me këtë akt, vetëm nga mesi i muajit qershor 1921, mund të thuhet se u tërhoq botërisht memorandumit. Edhe patriotët e kolonisë së Misirit, siç e provon protesta e tyre botuar në gazetën «Koha» të datës 4 qershor¹⁰, para këtij akti nuk e quanin të mënjanuar rrezikun që sillte me vete memorandumit për çështjen kombëtare. Këto rrethana e bëjnë të vështirë t'i japësh përgjigje pyetjes se përse Çajupi nuk e botoi artikullin rreth çështjes së memorandumit, që vazhdoi më se 4 muaj. Nuk do të ishte fare pa vend dyshimi mos artikulli i është dërguar ndonjë gazete, e cila për shkaqe të ndryshme mund të mos ta ketë botuar. Mirëpo gjendja në të cilën paraqitet artikulli, i shkruar pastër, me një kaligrafi të ngulët, pa zbrazëti për t'u plotësuar e pa koregjime, dëshmon për faktin se kjo është forma e tij përfundimtare, dhe nuk lë shteg të mendohet se dorëshkrimi mund të jetë kopja e artikullit, të dërguar në ndonjë gazetë të kohës.

Vendi që zë ky shkrim i Çajupit në krijimin e tij publicistik, është një problem më vete. Pa u marrë me sqarimin e këtij problemi, mund të themi se ky artikull, ndonëse nuk hyn në llojin e pamfleteve si «Klubi i Selanikut», ruan tiparet e stilit individual të Çajupit pamfletist dhe shquhet për mprehtësinë e gjykimit, forcën dërmuese të satirës dhe aftësinë për të shfrytëzuar me një mjeshtëri të veçantë mjetet e humorit dhe të frazeologjisë popullore.

Po japim këtu poshtë tekstin e plotë të transliteruar të artikullit «Dhe neve të krishterë jemi!» duke ruajtur të pandryshuar orografinë e orgjinali. Kemi hequr vetëm theksin që dallon shkronjën e nga ë-ja, si dhe vizën që ndan nyjen e përparme a trajtën e shkurtër nga fjala që vjen pas tyre.

DHE NEVE TË KRISHTERË JEMI!

«C'est plus qu'un crime, c'est une faute». 1)

Talleyrand

Dhe neve të Krishterë jemi, po jo si-kur se ata që nënshkruanë Memorandumin të Korçës. Jemi Shqipëtarë! Do-me-thënë, duamë Shqipërinë më tepër se kurr-gjë në jetë. Kristianë dhe Musulmanë, jemi Shqipëtarë, dhe besa, në vënd që të na ndajë, na bashkon, bën të duhemi si vëllezër, se besa s'ka tjetër qëllim,

7) Shih për këtë *Xvërtetim mbi memorandumin*, gazeta «Koha», 2.7.1921, f. 1.

8) Shih *Gjer këtu!* në gazetën «Koha», 18.VI.1921, f. 3.

9) Po aty.

xzë

10) Për dërgimin e kësaj proteste vendosi mbledhja e 6 majit 1921 e pleqësisë së Vëllazërisë «Bashkimi» ku merre pjesë edhe Çajupi si anëtar i pleqësisë. (Shih procesverbalin e kësaj mbledhjeje, që ruhet në Arkivin Qendror Shtetëror të RPSH, fondi i kolonisë shqiptare të Egjiptit).

1) «Ky është më shumë se një krim, është gabim».

tjetër themel veç bashkimin dhe dashurinë. Kristianët e Korçës janë ndë gabim: Ç'duan këta të bekuar? Ç'kërkojnë nga Qeverria jonë me një mënyrë t'ashpërt? Shqipëria Jugore të vetë-qeverriset, të ndaet prej Shqipërisë!.. Shkakun, arrësyen, na i thonë vetë: S'janë të kënaqur nga Musulmanët Shqipëtarë se këta lakëmuakan të bëjnë ndë Shqipëri një *Turqi të vogël!*¹²

Të çopëtonet pra Shqipëria: Musulmanët më nj'anë, dhe m'anë tjetër të Krishterët! E gjegje? Ti je im vëlla m'i madhi, nga një bark kemi lerë, një nënë kemi. Për një shkak a për një tjetër, një ditë qërtojmë dhe unë, nga inati, mohoj mëmën që na ka pjellë, s'e dua! Kështu gjan dhe me Kristianët Korçarë: qërtojnë me bashkatdhetarët Musulmanë! dhe me vrap, me një Memorandum të çmëndur, kërkojnë të copëtojnë Shqipërinë! Dhe nukë kuqen! Bënen veglë në duar t'armikut. Për një-mend, ç'tha Greku, ç'tha Serbi ndë Kongres të Paqit, ndë Paris, për të grabitur Shqipërinë? «Shqipëtarë s'ka! janë vetëm një tufë njerës t'egër, barbarë, ndarë në dy besë. Musulmanë dhe Kristianë, dhe me qënë që Musulmanët janë më tepër, Shqipëria e lirë, si shtet, ka me qënë një Tyrqi e vogël ndë Ballkan, punë që s'i përket shekullit të sorm!» Ndë gojë t'armikut këto fjalë s'kan'atë rëndësi që panden ky, se i mirret vesh qëllimi dhe lakëmimi q'ushqen ndë zëmër për të grabitur tokën shqipëtare, ashtu si ç'e provuan Shqipëtarët e Misirit me një *Memorandum*¹³ që botuan më 8 të Shkurtit 1919, për të paraqitur delegatëve të Konferencës ndë Paris. Po ndë gojë të Shqipëtarëve këto fjalë janë marrië, dhe jo vetëm po tradhëti, për Zonë! Pas vrasjes t'Esad faqe-ziut prej të bekuarit Rystem Avniut, thamë se u shua fara e tradhëtorëve ndë Shqipëri. Prandaj besojmë, a më mirë na vjen mbarë të besojmë, se ata që nënëshkruan, *Memorandumin* ndë Korçë janë krejt të marrë! Të marrë nga egotisma, nga madhënia, nga mënia, nga lakëmimi, nga dëshprimi që s'trashëgojnë dot nder e fitim ndë Shtet. Le të kemi pra mëshirë për të tillë fajtorë dhe le të besojmë se nuk do të vonojnë të vinë ndër mënd kur të ndëgjojnë bashkatdhetarët që protestojnë me një gojë; kur të shonë Shqipërinë të dëshpëruarë që po i mallëkon se kërkojnë t'i ndaen nga gjiri! Duet me vrap të pendohen nga thelp'i zëmërs, të gjukojnë vetë vedin, të dënojnë vepërimet e tyre, të marrën fjalën prapë e të heqin *Memorandumin* dhe të lypin ndjesë nga Qeverria. Në mos, po janë do-e-mos fajtorë, tradhëtorë, dhe Qeverria ka detyrë të marrë masa të forta, të rrepta dhe t'i dënojë pa mëshirë, t'i deklarojë jashtë ligjës për të mërguar ç'do farë rreziku prej atdheut.

Me të vërtet, po të mendonemi gjer'e gjatë, udha që kanë zënë të Krishterët Korçarë, shpie Shqipërinë në greminë; kërkimet që bëjnë janë për dëm t'atdheut t'onë. Po t'u mbaronet dëshira, qethen viset e Shqipërisë, s'mbetet shtet arbënor që të mundij të jetojë ndë liri. Vetë-qeverrimi a *autonomia* që shtiren si-kur kërkojnë, sa për tani, këta faqe-zes, për Shqipërinë jugore, është një mënyrë vepërimi për të bashkuar, më vonë, *Epirin e Veriut* me Greqinë! ... Ky pra, i vërteti qëllim i grekomanëve! Gjithë dhëlpëritë dhe llagëmet këtejë rjedhinë. Intriga nuk'është e tanishme: Më 1913, pasi Grekomanët, deshnë s'deshnë, bënë një krye ngritje ndë këto vise, Greqia me anë të grekomanit Kristaq Zografos, organizoi e vendosi një qeverri *autonome* të rreme për Epirin e Veriut, ndënë thundër të andarëve, të hajnavet, të *katilëve* të Greqisë, të cilët vranë, prenë, dogjnë; shkretuan sa deshnë ndë Shqipëri të Jugës!... Përse? që të mos njien këto vise si të Shqipërisë po, dorë-me-dorë, të vetë-qeverrisen dhe, më pastaj, të bashkonen me Greqinë!

Lufta që krisi më 1914 i preu sulmin Grekut, po ky i mallëkuar që gëzon sot liri nga gjaku i shqipëtarëve të moçim, s'do kurrë të heqë dorë nga Epiri a nga Shqipëria Jugore, s'lë rrast e çast për këtë qëllim, dhe me ndimë të grekomanëve Shqipëtarë, ka uzdajë ta çopëtojë Shqipërinë q'e shukon si halë në sy.

Ndaj themi, ndaj besojmë dhe tani se vepërimet e Korçarëve që nënëshkruanë *Memorandumin*, mos janë në program të Grekisë, a mos vazhdojnë dinakëritë dhe intrigat të propagandës të Qeverrisë greke ndë Shqipëri. Për njëmend, si përpara dhe tani, Epiri a Shqipëria Jugore është fusha e vepërimet; prapë shumë grekë e grekomanë; si që-moti dhe sot besa përdoret si shkak, si arrësye; prapë Qeveria greke duket në ballë të valles...

Si-do qoftë, koha sot është rrezikshme për Shqipërinë dhe fort e mbarë për llagëmet që na bëjn' armiqte; kufitë s'janë shiguruar as pak; Shteti Shqipëtar është nd'errëcirë, pa miq, pa kra; për kuntrë ka armiq të fortë të mërziut. Sot për sot, Shqipëria është varfër, s'ka t'ardhura, s'ka financa; administracia çalon se Qeverria s'ka mundur të përbënet me njers që duen, dhe s'ka mundur të punojë

12) Nënvizimet janë të gjitha të autorit.

13) Këtë memorandum, si dihet, e ka hartuar vetë Çajupi.

gjithë monë për dobi të vëndit e të popullit. Shumë herë qeverritarët vepërojnë jashtë rrugës, nofta dhe për dëm të njerit a të tjetërit. Mjerisht janë bërë plot gabime, disa vepra jashtë drejtësisë, dhe Kristianët të Korçës takon të kenë të drejtë të hidhënonen e të qërtojnë Qeverrinë. Me të vërtet shukojmë sot disa qeverritarë, disa nënëpunës, disa shqipëtarë faqe-zes që s'meritojnë shkallën e naltë ku gjënden, dhe jo vetëm që s'janë të zottë po janë dhe të dëmçim për atdhenë, dhe nukë shërbejnë veç se kuletën e vet me ç'do farë mënyre të poshtër. Kemi, bie fjala, ndë Parlamentë ndë Qeverri, ndë Këshillë të naltë do Grekomanë, do Turkomanë, do bejler'e pashallarë, do shejtanë të Krishter'a Musulmanë që mendojnë dhe vepërojnë për dreq dhe pas qefit, se harrojnë që kohët e para kaluan. Të tillë njers të rrezikshim, në vënd që të tboen a të varen, nderonen sot ndë Shqipëri, për dëshprim t'atdhetarëve të vërtetë. Po për këtë shkak a kemi të drejtë të mohojmë Shqipërinë për inat të disa Shqipëtarëvet keq-bërës? Jo, kurrë! se në vënd që të vëmë vetulla qitim sytë...

Shukoni me kujdes se ç'bënet ndë shtete të tjerë të moçim, të përparuarë, që trashëgojnë një jetë kombëtare prej qindra vjet. Dhe këtu, njers të pa-ditur, pa moral, pa mëshirë, njers të pa besë, egotistë, të poshtër, të shitun, tradhëtorë, harrijnë shumë herë në shkallët më të nalta të Shtetit, rrjepin, vjedhin, grabitin dhe mundojnë popullin q'i nderon!...

Po Shteti Shqipëtar, një shtet i ri që s'është dhe vendosur mirë, si mund të ketë një qeverri krejt të mbaruarë? S'kemi pra arsye të mos duamë Shqipërinë për inat të do atdhetarëvet që s'na pëlqejnë, si-kur punojnë Kristianët Korçarë që dëshirojnë të copëtojnë Shqipërinë për inat të Mohametanëvet Shqipëtarë, si-kur një nuse që fleti, thonë, me millonanë për inat të vjerrësë...

Jo, zotërinj! Shqipëria nuk' është as e Musulmanëvet as e të Krishterëvet, sa-do shumë sa-do pak qofshin. Shqipëria është e Shqipëtarëvet, qofshin Musulmanë, qofshin të Krishterë. Besa, fea, s'trazojnë në këtë punë. Besa është një mënyrë fort e pëlqyerë që të falemi te Perëndia. Për këtë qëllim, një Çifut dhe një Arap, të bekuar dhe të dërguar nga Fuqi-ploti, na rrëfyan, si cili-do, nga një mënyrë. Shqipëtarët, që të mos gabojnë kur falen, përdorin të dya mënyrat dhe kështu Zoti ndë Qiell le të pëlqejë dhe të marrë. Besë pra, mund të ketë shumë ndë këtë botë, atdheut është vetëm një. Musulman' e Kristianë, jetojnë ndë shumë vise të dheut, po Shqipëtarë quenë vetëm ata që lindin, rriten e vdesin ndë Shqipëri. Gjithë Shqipëtarët pra, si-do që të falen Zotit, janë vëllezër dhe sikur-se kanë një gjak ndë rrëmbe, një gjuhë, një zakon, ashtu duet të kenë një mendim, një qëllim, një shpresë një *ideal*, Shqipërinë.

